



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2536 / Prot.

Tiranë, më 22.10.2025

VENDIM

Nr. 52 Datë 22.10. 2025

**“PËR
MIRATIMIN E FORMULARËVE PËR PËRFITIM BURSË , PËRJASHTIM NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE , REDUKTIM
50 % NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, të VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019 në të cilat janë përcaktuar kriteret për studentët që përfitojnë bursë, përjashtim nga tarifa e shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe për reduktim të tarifës së shkollimit 50% për ciklin e dytë të studimeve, si dhe referuar shkresës së Administratorit nr.2379 datë 07.10.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.10.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa shkollimit për ciklin e parë të studimeve, reduktim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë deri më 15.12.2025.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria Juridike dhe e Zhvillimit të Kurrikulave , Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë Publikun dhe

Studentët, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI



Formulari nr. 1

**APLIKIM PËR BURSË DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2025 - 2026**

Emër Mbiemër i/ e studentit/es:

Fakulteti : FSHL ☐ FVFR ☐ FSHR ☐ Viti i studimeve : _____

Niveli i trajtimit me bursë një vit më parë 2025 — 2026 E plotë ☐ 1/2 Bursë ☐ I/e patrajtuar ☐

Në kolonën anësore vendos shenjë X për kriterin dhe dokumentacionin e paraqitur

**A. "KËRKESË PËR PËRFITIM BURSE DHE PËRJASHTIM NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Unë kërkuesi paraqes kërkesën time, pasi i përkas një prej kategorive të përcaktuara nga kriteri 1 deri në 11

Nr.	Lista e dokumentacionit	Shëno
A.	STUDENTET NE NEVOJE	
1.	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	
	Vërtetim që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet masa e ndihmës ekonomike (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) — dokument origjinal lëshuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.	
	Fotokopje e dokumentit të identitetit të studentit (Karte identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)	
2.	Bashkëshortët me femijë dhe që janë të dy student në IAI, publike	
	Vërtetim nga IAL-ja publike për secilin nga bashkëshortët;	
	Çertifikatë familjare / martese;	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)	
3.	Studentët që rezultojnë persona me aftësi të kufizuar	
	Vërtetim lëshuar nga KMCAP- dokument fotokopje e noterizuar ose e njehsuar me origjinalin.	
	Vërtetim për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar- dokument origjinal lëshuar nga institucioni përkatës.	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)	
4.	Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuar,	

	Vërtetim Iëshuar nga KMCAP — origjinale, për secilin prind	
	Vërtetim për përfitimin të pagesës së aftësisë së kufizuar — origjinale për secilin prind	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë.	
5.	Studentët që i kanë njërin prind pensionist dhe tjetri nuk jeton	
	Vërtetim për prindin bashkëjetues që trajtohet me pension pleqërie, lëshuar nga DRSSH përkatëse	
	Çertifikatën e vdekjes për prindin që është ndarë nga jeta	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë.	
6	Student i cili i ka të dy prindërit pensionistë	
	Vërtetim për secilin prind për trajtimin me pension pleqërie , lëshuar nga DRSSH përkatëse	
	Fotokopje e dokumentit të Identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	
7.	Studentët të tretët në rradhën e fëmijëve e Iart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë student në IAL Publike	
	Vërtetime origjinale për secilin nga dy fëmijët e parë, lëshuar nga IAL publike , ku ndjekin studimet	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	
8.	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit ,deri në moshën 25 vjeç	
	Dokument fotokopje e noterizuar e librezës së statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose Çertifikatë vdekje për secilin prind që nuk jeton më; Dokument që vërteton se janë të lindur jashtë martese; Vendim i gjykatës ku është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton ; Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prindërit dhe nuk ju njihet identiteti i tyre	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	
9.	Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç	
	Fotokopje e noterizuar e vendimit të formës së prerë gjykatës për humbjen e kujdestarisë prindërore	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	
10.	Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç	
	Dokument original që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	

11.	Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës	
	Dokument origjinal lëshuar nga institucioni përkatës , që vërteton se studenti është fëmijë të punonjësve të policisë së shtetit të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm , të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit , të forcave të armatosura , të shërbimit informative shtetëror dhe të policisë së burgjeve , që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	

B. "KËRKESË VETËM PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Unë kërkuesi paraqes kërkesën time , pasi i përkas një prej kategorive të përcaktuara nga kriteri 12-14

	Lista e dokumentacionit	Shëno
12	Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë dhe egjiptianë	
	Deklaratë noteriale e studentit, ku vetë deklarohet se i përket komunitetit rome dhe egjiptianë	
	Fotokopje i dokumentit të identitetit të studentit(Karte identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)	
13	Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët fëmijë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie	
	Vërtetim original nga Instituti i Integritetit të të përndjekurve politikë , që vërteton se student ka statusin "Fëmijë i ish të dënuarit dhe të përndjekurit politik nga sistemi komunist"	
	Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë.	
14	Studentët , të cilët kanë të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuara , të vërtetuar nga KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar"	
	Vërtetim lëshuar nga KMCAP- dokument fotokopje e noterizuar ose e njehsuar me origjinalin.	
	Vërtetim për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar- dokument origjinal lëshuar nga institucioni përkatës.	
	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë	

❖ **Përfitojnë bursë:**

- ❖ Studentët e regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve, në vitet pas të parit, që rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës akademik të përlogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik, nga Universiteti i Sporteve të Tiranës.
- ✓ Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.
- ✓ Lista konfirmohet nga Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digiitalizimit të Shërbimeve Akademiko- Shkencore dhe Fakulteteve përkatëse.

NUK PERFITOJNË BURSE OSE PERJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT STUDENTËT

- 1 . Kanë mbaruar studimet në një program studimi dhe vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi, nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
- 2 . Janë përsëritës me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

Dokumentacioni dorëzohet nëpërmjet rrugës postare në adresën : Universiteti i Sporteve të Tiranës , Rr.Muhamet Gjollësja, Tiranë ose pranë Zyrës së Arkiv-Protokollit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës

Emër Mbiemër

nënshkrimi i studentit

Nr. Cel: _____ Adresa e-mail: _____

Tiranë më _____ 2025

FORMULAR DEKLARIMI

1-Unë i/e nënshkruari/a student/e në

Fakultetin _____

në vitin e _____ me kartë identiteti _____

e-mail: _____, Tel: _____ aplikoj për përfitim burse

dhe/ ose përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026, dhe deklaroj si më poshtë:

1. Jam njohur me kriteret dhe parashikimet e akteve nënligjore për përfitim burse dhe/ose përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe i pranoj ato.
2. Autorizoj Universitetin e Sporteve të Tiranës për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim si dhe publikimin e tyre.
3. Autorizoj Universitetin e Sporteve të Tiranës për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhënajo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore nëfuqi.

Dorëzuesi

Marrësi në dorëzim .

(Emër Atësi Mbiemër i aplikantit)

Firma

(Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin)

Firma

Tiranë më _____ . _____ 2025

Lista e dokumentacionit që dorëzon studenti për aplikim për përfitim burse dhe/ose
përfshirje nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026

Nr	Lloji i dokumentit	Nr. i fletëve
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. _____ Prot.

Tiranë më datë _____ 2025

Formulari nr. 2

**PRAKTIKË PËR PËRJASHTIM 50% NGA PAGESA E TARIFES SË SHKOLLIMIT
PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE NE UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS - ME KOHË TE PLOTË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026.**

Kërkesa plotësohet në bazë të: VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", për vitin akademik 2025-2026.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES

(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjën X ose rumbullako)

Emri			Datëlindja	____/____/____	
Atësia			Nr. i letërnjoftimit		
Mbiemri			Gjinia	M ☐	F ☐
Fakulteti/ Programi i studimit	FSHL -Shkencat e Levizjes	FVFR Fakulteti I Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Cikli i studimit	II	
	☐	☐	Viti I studimit	MP	MSH
	Përrjashtim 50 % nga Tarifa Shkollimit				

Unë kërkuesi paraqes KËRKESË për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student në UST dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi që rregullojnë tarifat vjetore të shkollimit në LAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kushteve të renditura në vijim janë në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumente zyrtare të marra në institucionet shtetërore të njohura me ligj. Shpreh dakortësinë time për përpunimin dhe verifikimin e të dhënave personale të mia.

Jam në dijeni se deklaratimet e reme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumenteve të fallsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe më detyron të kryej pagesën e kësaj tarife sipas afateve të përcaktuara në njoftimin e bërë nga strukturat e UST-së. Dokumentet shoqërues janë origjinal ose kopje të noterizuara.

Kriteri 1. Student që Vjen nga shtetesa sociale: student me aftësi të kufizuara të vërtetuara me vendim KMCAP

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e Vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
- Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr studenti
- Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethitpërkatës
- Fotokopje e noterizuar e statusit të paraplegjikut/teraplegjikut
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 2. Student që vjen nga shtresa sociale studente Femijë të personave /familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim KMCAP për punë, familjet e të cilëve trajtohen/ përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar, ndihmën ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

☐

- Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCAP-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për studentin me prirje me aftësi të kufizuara (invalid punë, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik); - Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfituar sipas statusit të invalidit të punës - Vërtetim origjinal i Institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit
- Vërtetim origjinal për trajtim/përfitim ndihme ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësia e vetëqeverisjes vendore; (Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësies së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vëlosur)
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 3 :Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësia e bazë të vetëqeverisjes vendore. :

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. (Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar numrin e dosjes dhe të jetë shënuar qartë shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësies së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vëlosur.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 4: Student që vjen nga shtresa sociale: Student deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, të ardhurat vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve.

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Çertifikatë vdekjeje e prindit që u është ndarë nga jeta;
- Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë

- Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë; ose
- Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që asnjë nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjec) nuk ushtrojnë aktivitetprivat;
- Vërtetime nëse prindërit apo ndonjë pjesëtar i familjes mbi 18 vjec janë të regjistruar si punëkërkues të papunë (nga zyra e punës);
- Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (nëse përfitojnë pension ose jo). Vërtetim nese familjarët kanë tokë ose pasuri të paluajtshme fitimprurëse në pronësi;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 5 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjec.

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e librezës për përfitimin e statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror,
- Çertifikatë vdekje që vërteton që ka humbur të dy prindërit.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 6 Student që vjen nga shtresa sociale: Studëntët deri ne moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me Vendim gjykate të formës së prerë.

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të formës së prerë të gjykatës për humbjen e kujdestarisë prindërore ose është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nukjeton ose Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 7 Student që vjen nga shtresa sociale: Studëntët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime te trafikut te qenieve njerezore dhe kane perfituar statusin ligjor per trajnim si viktime te trafikut te qenieve njerezore.

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktime të trafikut të qenieve njerezore, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 8 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe mbrojtjes.

☐

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se student është fëmijë të punjonjësve të të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjari dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në ose për shkak të detyrës, lëshuar nga ministria përkatëse;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 9 Student që vjen nga shiresa sociale: Studentët romë / ballkano-egjiptian .

☐

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se studenti i përket komunitetit romë dhe ballkano-egjiptianë lëshuar nga ministria përgjegjëse për mirëqënien sociale
- Deklaratë noteriale;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 10 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët femije të ish-dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose femije me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

☐

- Vërtetimi i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga ministria e punëve të brendshme.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 11 Student që rezultojnë me notë mesatare vjetore 9(nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës

- ✓ Lista konfirmohet nga Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko- Shkencore dhe Fakulteteve përkatëse.

KËRKUESI

Emri Mbiemri nenshkrimi

Tiranë , më____.____.2025

FORMULAR DEKLARIMI (PER CIKLIN E DYTE TE STUDIMEVE)

Unë i/e nënshkruari/a_____ student/e në

Fakultetin

_____ në vitin e_____ me kartë identiteti_____

e-mail:_____, Tel:_____ , aplikoj për

përrjashtim 50% nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026, dhe deklaroj si më poshtë:

1. Jam njohur me kriteret dhe parashikimet e akteve nënligjore për përrjashtim 50% nga tarifa vjetore e shkollimit dhe i pranoj ato.
2. Autorizoj Universitetin e Sporteve të Tiranës për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim si dhe publikimin etyre.
3. Autorizoj Universitetin e Sporteve të Tiranës për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhënajo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore nëfuqi.

Dorëzuesi

(Emër Atësi Mbiemër i aplikantit)

Firma

Marrësi në dorëzim

(Emër Mbiemër i punonjësit qëpranoi aplikimin)

Firma

Tiranë, më. _____ 2025

Lista e dokumentacionit që dorëzon studenti për aplikim për përjashtim 50% nga tarifa
vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026

Nr	Lloji i dokumentit	Nr. fletëve
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		